



Dobitë e urisë vullnetare dhe të këqijat e ngopjes

## Description

Imam Gazaliu

*Burimi: Abu Hamid al-Ghazali, Al-Ghazali? on Disciplining the Soul: Kit?b Riy??at al-Nafs & On Breaking the Two Desires (Kitab Kasr al-Shawatayn), trans. T.J.Winter, (Cambridge: The Islamic Text Society), 117-132*

*Një ekspozë e dobive të urisë dhe të këqijave të ngopjes*

I Dërguari i Zotit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë) ka thënë: “Luftojini vetet tuaja nëpërmjet urisë dhe ejtjes, pasi kjo sjell shpërblim...”<sup>[1]</sup>

Tani, ti mund të pyesësh: “Ky virtyt i madh që i bashkangjitet urisë: nga cila gjë buron, dhe çfarë arsyeje ka? Pasi uria nuk konsiston në asgjë tjetër përveç se të lënduarit e stomakut dhe të duruarit e vuajtjeve, dhe nëse ka shpërblim në gjëra të tilla, atëherë njeriu duhet të shpërblehet bujarisht për çdo lëndim që ai pëson, përfshirë goditjet që ai drejton kundër vetvetes, prerjen e mishit të tij, gëlltitjen e objekteve të neveritshme, dhe veprime të ngjashme.” Mirëpo, ti duhet ta dish se fjalë të tilla i përngjajnë deklaramit të një njeriu i cili merr barna dhe përfiton nga to, dhe i cili, teksa deklaron se dobia e tyre buron nga të qenit e tyre të pakëndshme e tyre dhe nga shija e tyre e hidhur, atëherë zë e gëlltit gjithçka që ka shije të pakëndëshme. Kjo është një sjellje e gabuar, pasi dobia shtrihet në një cilësi të veçantë që është e pranishme tek barnat, dhe jo në shijen e tyre të hidhur. Pikërisht sikurse vetëm mjekët janë të ndërgjegjshëm për këtë cilësi, kështu, edhe arsyeja për natyrën dobiprurëse të urisë është e ditur vetëm nga dijetarët e mëdhenj. Cilido që e shtyn veten që të ketë uri, mbasi ka besuar tekstet e shpallura që lëvdojnë urinë, duhet detyrimisht të nxjerrë dobi, madje edhe nëse ai nuk e di përse ajo është dobiprurëse, në po të njëjtën mënyrë të një njeriu i cili merr barna, dhe ai përfiton pa iu thënë atij se si këto i sjellin dobi atij. Por pavarësisht nga kjo, ne kemi për ta sqaruar këtë çështje

për t'iu bërë dobiatyre që dëshirojnë të ngrihen nga niveli i besimit në atë të diturisë, pasi Zoti ka thënë: *Zoti ka për t'i lartësuar ata që besojnë në gjirin tuaj, dhe ata që kanë dije, në gradë të larta.* [2]

Uria ka dhjetë përfitime:

[1] E para nga këto është dëlirësimi i zemrës, ndriçimi i disponimit natyror dhe mprehja e shquarsisë shpirtërore (*basira*) të njeriut.[3] Sepse ngopja i jep jetë budallallëkut dhe verbërisë në zemër, dhe shton avujt e trurit që prodhojnë një trajtë të dehjes, ashtu që burimet e mendimit ndrydhen dhe zemrës i duket një gjë e rëndë që të mendojë dhe të perceptojë gjërat me ndonjë farë shpejtësie. Një fëmijë, kur ha tej mase, bëhet i pazoti për të ruajtur gjërat në kujtesë, dhe mendja e tij korruptohet aq sa ai bëhet i squllët dhe i mefshtë.

Ka thënë Ebu Sulejman el-Daraniu: “Bëjeni veten të ketë uri, pasi kjo e ul neftin, zbut zemrën, dhe prodhon dituri qiellore.”

Dhe [Profeti] (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë) ka thënë: “Jepnu jetë zemrave tuaja duke qeshur rrallë, dhe dëlirësojini ato me uri, pasi ato do të bëhen të kthjellëta dhe të buta”. [4]

Dhe thuhet: “Uria është si vetëtimë, kënaqja me fatin tënd është si një re, dhe urtësia është si shiu”.

Dhe Profeti ka thënë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë): “Kur një njeri e bën barkun e tij që të ketë uri, ai e bën mendjen e tij që të mendoj fuqishëm dhe zemrën e tij që t'i rritet mprehtësia”. [5]

Ka thënë Ibn Abasi: “Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) njëherë tha: “Cilido që e mbush barkun plot dhe mandej e zë gjumi, atij zemra ka për t'iu bërë më e ngurtë”. Paskëtaj ai deklaroi: “Ka një zekat për gjithçka, dhe zekati i stomakut është uria”. [6]

Ka thënë el-Shibliu: “Kurrë nuk kam patur uri për një ditë të vetme pa vrojtuar në zemrën time një portë të hapur të urtësisë dhe një aftësi për të qortuar veten, të cilën kurrë më parë nuk e kisha vërejtur.”

Është e qartë se qëllimi që kanë aktet e adhurimit është një arsyetim [*fikr*] i cili e shpie njeriun drejt gnozës [*ma'rife*] dhe një perceptim i brendshëm në thellësinë e realiteteve të Zotit [*el-istibsar bi-haka'ik el-hakk*]. Ngopja e përjashton një gjë të tillë, ndërkohë që uria e hap katërsh portën e saj. Gnoza është një nga portat e Qiellit, dhe është mëse e drejtë që uria e vazhdueshme duhet të përbëjë një trokitje në njërin prej këtyre portave. Ishte pikërisht për këtë arsye që Llukmani i tha të birit të tij: O biri im! Kur stomaku është plot, atëherë intelektin e kaplon gjumi, urtësia bie në heshtje dhe pjesët e trupit janë tejet të plogështa për të kryer çdo akt adhurimi.”

Ka thënë Ebu Jazid el-Bistamiu: “Uria është një re; sa herë që një rob është i uritur, zemra e tij derdh urtësinë si shi.”

Ka thënë Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë): “Drita e urtësisë vjen nga uria, ndërkohë që largësia nga Zoti (i Madhëruar dhe i Lëvdur qoftë Ai) vjen nga ngopja, dhe afërsia me Atë vjen nga dashuria për skamnorët dhe të qëndruarit afër atyre. Për pasojë, mos hani kurrë deri në ngimje, pasi nëpërmjet kësaj ju do të shuani dritën e urtësisë që është në zemrat tuaja. Njeriu i cili e

kalon natën e tij duke u lutur, mbasi ka ngrënë lehtë, është i rrethuar gjithë natën nga Hurijet derisa të zbardhë drita.”<sup>[7]</sup>

[2] Dobia e dytë është një butësi dhe dëlirësi e zemrës, me anë të së cilës ajo përgatitet që të përftojë kënaqësinë e ligjëritimintim me Zotin dhe që të preket nga përkujtimi i Tij. Sa e sa akte përkujtimi ekzistojnë të cilat bëhen me gjuhë dhe me një zemër të vëmendshme, ndërkohë që zemra megjithatë dështon të gjejë ndonjë kënaqësi në të dhe nuk preket prej saj, deri në atë masë sa që a thua se ekziston një perde që është e përbërë nga ngurtësia e zemrës! Mirëpo, kur ajo zbutet në sajë të rrethanave të caktuara, ajo ka për të qenë e prekur në mënyrën më të fuqishme nga përkujtimi dhe ka për të marrë kënaqësi të madhe në të kuvenduarit me Atë. Zakonisht, arsyeja për këtë është një stomak bosh.

Ka thënë Ebu Sulejman el-Daraniu: “Adhurimi është më i ëmbël për mua kur barku im kapet fort mbas shpinës sime”.

Ka thënë el-Xhunejdi: “A mund të vendosë një njeri një masë ushqimi ndërmjet tij dhe kraharorit të tij, dhe akoma të shpresojë të gjejë ëmbëlsinë e kuvendimit intim me Zotin?”

Ka thënë Ebu Sulejmani: “Kur zemra është e uritur dhe e etur, ajo bëhet më e kthjellët dhe më e butë, ndërkohë që kur është e nginjur, ajo bëhet e verbër dhe e ashpër.”

Kësodore, influenza e ushtruar mbi zemrën nga kënaqësia e kuvendimit intim [*munaxhat*] lehtëson mendimin dhe përfitimintim e gnozës, duke ofruar rrjedhimisht një dobi të dytë.

[3] Dobia e tretë shtrihet në përluljen dhe poshtërimintim, si dhe në heqjen e ngazëllimit, argëtimit dhe shkapërderdhjes, të cilat përbëjnë zanafillën e kryeneçësisë dhe pavëmendshmërisë ndaj Zotit (i Lartësuar është Ai). Sepse vetja (nepsi) nuk përulet dhe poshtërohet nga asgjë tjetër më efikase se sa uria, e cila, kur mbizotëron, e bën atë t’i japë patrazuar besën Zotit të saj dhe frikësohet nga Ai, dhe të jetë e vetëdijshme për pafuqishmërinë dhe poshtërimintim e saj kur ajo dobësohet dhe bëhet e dëshpëruar për kafshatën e bukës që i mungon, ashtu që e gjithë bota e paraqitet e errët një njeriu për shkak se një pirje uji nuk erdhi kur ai e dëshiroi atë. Sepse për sa kohë që ai dështon të shohë poshtërsinë dhe pafuqishmërinë e vetvetes së tij, ai ka për të qenë i pazoti për të parë lavdinë dhe fuqinë e Zotit të tij: lumturia e tij shpëtimtare, pra, shtrihet në të parit e vetes përherë si e ulët dhe e pafuqishme, dhe në të parit e Zotit të tij si i Lëvduar, i Fuqishëm dhe i Pushtetshëm. Le të jetë ai, pra, i uritur pareshtur, i shtrënguar që të kthehet tek Zoti i tij në mënyrë të tillë që ai të dëshmojë shtrëngimin e tij nëpërmjet përvojës [*dheuk*]. Për këtë arsye, kur Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë) iu ofruan bota dhe të gjitha thesaret e saj, ai tha: “Jo! Unë më mirë do të vuaja urie një ditë po e një ditë jo, kështu që kur të kem uri, unë mund të kem qëndresë të duruar, dhe kur ta mbush barkun unë të kem mirënjohje” (ose siç ka thënë ai).<sup>[8]</sup> Sepse nepsi për ushqimin dhe dëshira për femra përbëjnë një rën nga portat e Ferrit, dhe zënë fill tek ngopja. Përkundrazi, poshtërimi dhe përlulësia janë njëra nga portat e Parajsës, dhe zënë fill tek uria. Cilido që mbyll një rën nga portat e Ferrit ka hapur detyrimisht nëpërmjet kësaj një rën nga portat e Parajsës, meqenëse ato kundërshtojnë njëra tjetrën, njëllloj si lindja dhe perëndimi: afërsia me një rën është largësi nga tjetra.

[4] Dobia e katërt është se një njeri kurrë nuk shkon deri aty sa të harrojë sprovat dhe mundimet e Zotit, apo ata që kaplohen prej tyre. Sepse njeriu i ngopur është i prirur t'i harrojë ata njerëz që janë të uritur, dhe të harrojë edhe vetë urinë. Robi inteligjent nuk sheh kurrë një fatkeqësi pa përkujtuar fatkeqësitë e Jetës së Amshuar: kur ka etje, ai përkujton etjen nga e cila njerëzit do të vuajnë në rrafshinat e gjera të Ditës së Kijametit, dhe kur ka uri, ai sjell në kujtesë urinë e njerëzisë së Ferrit, e cila është kaq e skajshme sa që ata kanë për të dëshiruar që të hanë edhe fruta me gjemba, dhe frytin e pemës së Zekumit, dhe të pinë *ghassak*-un dhe plumbin e shkrirë. Një rob nuk duhet ta harrojë kurrë dënimin, mundimet dhe gjëmat<sup>[9]</sup> e Jetës së Amshuar, sepse janë pikërisht këto që zgjojnë frikën: cilido që nuk është në një gjendje përulësie, sëmundjeje, varfëria dhe fatkeqësie, ai ka për ta harruar Jetën e Amshuar, e cila rrjedhimisht ka për të dështuar për të qenë e dukshme në vetveten e tij apo dominuese në zemrën e tij. Pikërisht për këtë arsye robi duhet të pësojë një sprovë, apo të dëshmojë sprovën e të tjerëve – dhe gjëja më e përshtatshme me të cilën ai duhet të vihet në sprovë është uria. Sepse krahas të përkujtuarit të thjeshtë të mundimit të Jetës së Amshuar, ajo përmban një mori të madhe përfitimesh të tjera; e cila është njëra arsye përse Profetët dhe Evlijatë ishin veçanërisht të kapluar nga sprovat, ku më të mirët në gjirin e tyre kanë qenë ata që kanë vuajtur më tepër nga të gjithë.<sup>[10]</sup> Për rrjedhojë, kur Jusufi (paqja qoftë mbi atë) u pyet: “Përse vuan urie, kur ti në duart e tua ke depot e tokës?” ai u përgjigj: “Kam frikë se unë mund ta mbush barkun plot, dhe kësisoj harroj të uriturit”. Të sjellësh në kujtesë ata që janë të uritur dhe nevojtarë është, pra, njëra nga dobitë e urisë, meqenëse kjo gjendje ka për të të shpënë në dhembshuri, ushqyerje të të uriturve, dhe bamirësi karshi krijesave të Zotit; në kundërdallim, njeriu i cili është i nginjur, është i shkujdesur ndaj atyre që kanë uri.

[5] Dobia e pestë dhe më e madhe shtrihet në thyerjen e të gjitha dëshirave të tua për mëkatin, dhe në arritjen e kontrollit mbi veten e cila urdhëron të keqen. Sepse të gjitha gjynahet zënë fill në dëshirat dhe fuqitë e njeriut, lënda e parë e të cilave në çdo rast është ushqimi: kur njeriu ha më pak, çdonjëra nga dëshirat dhe fuqitë e tij kanë për t'u molisur. Lumturia shpëtimtare [*se'ade*] e njeriut konsiston fund e krye në kontrollin që ai zotëron mbi vetveten e tij, ndërkohë që mallkimi dhe mjerimi rezultojnë kur vetvetja e tij e kontrollon atë. Pikërisht sikurse ti nuk mund t'i vësh frerë një kafshe shale kryeneçe pa e dobësuar atë nëpërmjet [mungesës së] ushqimit, pasi kur ajo e mbush barkun plot bëhet e fortë, kokëfortë dhe sfiduese, kështu ndodh me vetveten.

Pyetën njëherë dikë: “Përse ti pavarësisht moshës tënde të thyer nuk kujdesesh për trupin tënd, i cili është bërë i rrënuar?” Ai iu përgjigj: “Për shkak se ai bëhet me shpejtësi i harbuar dhe i ngazëllyer: trembem se ai mund të turret rrufeshëm dhe më rrëzon përdhe. Parapëlqej më mirë ta detyroj atë të kryejë veprime të vështira se sa të detyrohem prej tij që të ktyej akte prishjeje”.

Ka thënë Dhu'l-Nuni: “Nuk e kam mbushur kurrë barkun plot pa kryer më pas, apo pa dashur të kryejë, ndonjë gjynah”.

Ka thënë Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj): “Risia [bidati] e parë që u shfaq mbasi Pejgamberi i Zotit vdiq ishte se njerëzia e mbushnin barkun plot, dhe kur barqet e tyre ishin të nginjur, vetvetet e tyre turrehin rrufeshëm tok me ata drejt gjërave të dynjasë”.<sup>[11]</sup>

Kjo nuk përbën thjesht një dobi të vetme; më saktë, ajo është depoja e të gjitha dobive. Për këtë arsye është thënë se “uria është njëra nga depot e Zotit”. Gjëja më e paktë që mënjanohet me anë të urisë është dëshira seksuale, dhe gjithashtu dëshira për të folur; sepse në rastin e një njeriu të uritur,

dëshira për të folurën e panevojshme nuk zgjohet, dhe kjo i jep atij mundësinë ta shpëtojë veten nga gabimet e gjuhës, si shpifja, fjalët e pista, gënjeshtria, përgojimi e kështu me radhë, nga të cilat ai bëhet i përmbajtur në sajë të urisë. Kur, në kundërdallim, ai është i ngopur, ai ka për të patur nevojë që të dëfrehet, dhe ka për t'u argëtuar detyrimisht duke nënvlerësuar njerëzit e tjerë, dhe “njerëzit flaken mbi hundët e tyre në Ferr vetëm prej të korrave të mbledhura nga gjuhët e tyre”.<sup>[12]</sup>

Sa për dëshirën seksuale, rreziku është mëse i dukshëm, uria e mposht të keqen që ajo përmban, ndërkohë që kur një njeri është i nginjur ai nuk mund ta sundojë dëshirën e tij seksuale: edhe sikur ai të jetë i mbrojtur nga droja prej Zotit, ai ka për ta patur të pamundur të kontrollojë sytë e tij, dhe madje edhe sytë bien në mëkatin e shturjes siç ndodh me gjenitalet.<sup>[13]</sup> Dhe në ndodhtë që ai është në gjendje t'u vërë frerë syve të tij duke ulur vështrimin, ai sërish ka për ta patur të pamundur që të kontrollojë mendimet e tij, të cilat kanë për t'u bërë të ndyra, kështu që diskursi që vetvetja do t'i mbajë atij në lidhje me shkaqet e dëshirës seksuale ka për t'ia shkëputur vëmendjen nga kuvendimi i tij intim [me Zotin], ndoshta edhe teksa ai kryen faljen e Namazit. Ne përmendim rrezikun gjuhës dhe të gjenitaleve vetëm si një shembull; megjithatë, të gjitha gjynahet e shtatë ekstremiteve<sup>[14]</sup> rezultojnë nga fuqia që lind prej mbushjes plot të barkut. Një njeri i urtë ka thënë: “Kur njeriu e përmban veten me durim, dhe këmbëngul në ngrënien e bukës dhe të asgjëje tjetër për një vit, dhe mbush vetëm gjysmën e barkut të tij, Zoti e çliron atë nga dëshira e tij për gra.”

[6] Dobia e gjashtë konsiston në neverinë nga gjumi, në përfitim të zotësisë për të qëndruar zgjuar për periudha të gjata. Një njeri që e mbush barkun ka për të pirë me tepri, dhe cilido që pi me tepri ka për të fjetur gjithashtu me tepri. Për këtë arsye njëri nga Shehlerët, sa herë që servirej ushqim, e kish zakon të thonte: “O muridë [aspirantë] të mbledhur këtu! Mos hani shumë, që të mos pini shumë, gjë e cila ka për t'ju bërë që të fleni shumë, dhe, për pasojë, të humbisni shumëçka.”<sup>[15]</sup> Shtatëdhjetë Evlija të Vërtetë janë pajtuar se gjumi i bollshëm është pasojë e pirjes së ujit me tepri. Të fjeturit me tepri është çuarje dëm e jetëgjatësisë tënde, dhe bën që të humbasësh namazin e *Tehexhhud*-it (natës)<sup>[16]</sup> dhe rezulton në një natyrë të mpirë dhe një ngurtësi të zemrës. Jetëgjatësia është më e çmuara e xhevahirëve, dhe përbën kapitalin e një robi me të cilin ai bën tregti; gjumi, në krahun tjetër, është një [lloj] vdekje,<sup>[17]</sup> pasi kur plotësohet me tepri ai shkurton jetën e robit. Krahas kësaj, vlera dukshëm e madhe që i bashkangjitet namazit të *Tehexhhud*-itka për t'i ikur atij nëse ai fle me tepri, dhe në qoftë se një njeri është i kapluar nga të qenit i përgjumur ai nuk ka për ta shijuar ëmbëlsinë e adhurimit.

Një njeri i pamartuar, kur ai fle i ngopur, ka mundësi të përjetojë një ëndërr të lagësht, e cila gjithashtu ka për ta penguar atë nga kryerja e namazit të natës së vonë, meqenëse ai ka për të patur nevojë që të kryejë pastrimin kryesor, qoftë me ujë të ftohtë, gjë e cila ka për t'iu dukur e pakëndëshme – ose në banjat publike [*hamame*], të cilat ai mund të mos jetë në gjendje t'i vizitojë natën, kështu që ai e humbet vitrin<sup>[18]</sup> (në ndodhtë që ai ta ketë shtyrë atë deri në kohën e namazit të *Tehexhhud*-it). Ai po ashtu lipset të paguajë për *hamamin*, ku vështrimi i tij mund të bjerë mbi pjesët intime të njerëzve që gjenden atje me atë: pasi ky vend përmban rreziqe të shumta (të cilat ne i kemi përmendur në *Librin e Dëlirësisë*).<sup>[19]</sup> Të gjitha këto gjëra rezultojnë nga mbushja e barkut plot. Ebu Sulejman el-Daraniu vërejti njëherë se “ejakulimi nokturnal është një ndëshkim”, pasi kjo pengon që të kryhen forma të shumta adhurimi si pasojë e pamundësisë së kryerjes së pastrimit të madh aty për aty.<sup>[20]</sup>



Gjumi, për pasojë, është vetë burimi i gjendjeve të pafavorshme, dhe ngopja shpie në të, ndërkohë që uria e shkurton atë.

[7] Dobia e shtatë është se aktet e gjata të adhurimit bëhen më të lehta. Ushqimi e pengon një njeri nga adhurimi i madh, meqenëse ai ka nevojë për kohë në të cilën ai të merret me ngrënien, dhe mund të kërkojë kohë për blerjen dhe gatimin e ushqimit gjithashtu. Ai ka nevojë për kohë për të larë duart e tij, dhe për të pastruar dhëmbët, dhe ka për të shkuar shpesh në banjë për shkak se ka pirë shumë. Sikur ai të shpenzonte orët e përdorura në këto aktivitete në përkujtimin e Zotit, në kuvendimin intim me Atë, dhe në llojet e tjera të adhurimit, ai do të përfitonte së tepërmi.

Ka thënë el-Sariu: “pashë njëherë Ali el-Xhurxhanin teksa hante qull elbi me gishta. “Ç’të shtyu ta bëje këtë gjë?” e pyeta unë. “Kam përlllogaritur,” u përgjigj ai, “se diferenca ndërmjet përtypjes [së bukës] dhe ngrënies në këtë mënyrë është shtatëdhjetë tesbih “i Lëvduar është Zoti” [*subhanallah*]. E kështu, unë nuk kam përtypur bukë për dyzet vjet.”

E shikon se sa i shqetësuar ka qenë ai për kohën: ai madje nuk do ta çonte atë dëm me përtypje! Çdo frymëmarrje e jetëgjatësisë së një njeriu është një xhevahir i paçmueshëm, dhe, meqenëse ai ka për të mbledhur një shtëpi të madhe thesari me kësi xhevahirësh të cilët do të mbijetojnë deri në Jetën e Amshuar, ai duhet ta drejtojë veten e tij për tek përkujtimi dhe adhurimi i Zotit (i Lartësuar është Ai).

Ndër gjërat që bëhen të pamundura nga ngrënia e tepruar janë ruajtja e dëlirësisë rituale dhe kalimi i një kohe të madhe në xhami, pasi një njeri që ha me bollëk është i detyruar që të largohet nga xhamia në mënyrë që të kryejë ujtë e hollë. Ndër to është gjithashtu edhe agjërimi, i cili është më i lehtë për atë njeri që e ka mësuar veten me urinë. Agjërimi, tok me kalimin e një kohe të gjatë në xhami, dhe të qëndruarit në gjendjen e dëlirësisë rituale, dhe të shndërruarit vaktet e të ngrënit në vakte adhurimi, prodhojnë një përfitim të madh që mund të përbuzet vetëm nga ata që janë të shkujdesur dhe nuk e dinë vlerën e fesë, dhe të cilët janë *të kënaqur me jetën e kësaj bote, dhe ndihen të sigurtë aty,* [21] *dhe të cilët njohin vetëm pamjen e jetës së kësaj bote, dhe janë të shkujdesur për Jetën e Amshuar.*

[22] Ebu Sulejman el-Daraniu ka nxjerrë në pah gjashtë dëme të ngopjes duke thënë: “Cilido që ha deri aty sa e mbush barkun plot shoqërohet nga gjashtë të meta: ai humbet ëmbëlsinë e të kuvenduarit me Zotin, ai e ka të pamundur të memorizojë urtësinë Hyjnore, atij i mohohet dhembshuria për të tjerët (meqenëse kur ai është i ngopur përfytyron se çdokush tjetër është po njësoj i ngopur), atij i duket adhurimi i rëndë, dëshirat e tij bëhen më të forta, dhe, në një kohë që besimtarët e tjerë janë në xhami, ata që kanë ngrënë dingas janë te prigjet e plehrave dhe në nevojtoje, për të zbratur stomaqet e tyre”.

[8] Dobia e tetë është shëndeti trupor që rezulton nga ngrënia e pakët. Sepse sëmundjet shkaktohen nga ngrënia e tepërt, dhe nga prania e një teprice përzierjesh në stomak dhe në arterie. Sëmundja e pengon njeriun nga adhurimi; e huton zemrën dhe i zë rrugën përkujtimit dhe reflektimit; ajo e çon dëm jetën, dhe e shtrëngon njeriun që t’i nënshtrohet nxjerrjes së gjakut dhe vendosjes së kupave, si dhe marrjes së barnave dhe vizitës te mjekët, dhe këto të gjitha kërkojnë para, që nga ana tjetër mund të përftohesh vetëm nëpërmjet gjërave që lipsin rraskapitje në shmangien e llojeve të ndryshme të gjynaheve dhe dëshirave. Uria i bën të gjitha këto të panevojshme.

Kallëzohet se [Harun] el-Rashidi thërriti një ditë katër mjekë: një indian, një grek, një irakian dhe një savadi, dhe u tha: “Le të përshkruajë secili prej jush atë ilaç që nuk sjellë asnjë sëmundje”. Indiani hapi gojë i pari, dhe tha: “Në gjykimin tim, ilaçi që nuk përmban asnjë sëmundje është mirobalani i zi.”[23] Mandej irakiani tha: “për mua, është lakra e ujit”. [24] Greku tha: “Mendoj se është uji i nxehtë”. Dhe savadiu (i cili ishte më i dituri prej tyre) tha: “Mirobalani gërryen stomakun, dhe kjo është një sëmundje më vete. Lakra e ujit e bën stomakun të vajisur, dhe kjo është një sëmundje më vete gjithashtu. Uji i nxehtë e shtendos stomakun, dhe kjo gjithashtu përbën një sëmundje më vete.” Dhe kështu, al-Rashidi e pyeti atë: “Atëherë, cila është përgjigja jote?” Dhe ai u gjegj: “Në gjykimin tim, ilaçi që nuk përmban asnjë sëmundje qëndron në të përmbajturit nga ushqimi derisa të lindë oreksi, dhe në të pushuarit së ngrëni sa pa u ngopur ende mirë”. “Ti ke folur me vërtetësi,” deklaroi ai.

Njëri nga Populli i Librit[25], i cili ishte filozof dhe gjithashtu mjek, dëgjoji njëherë thënien e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë), “Një e treta për ushqim, një e treta për pije, dhe një e treta për frymë.” I mrekulluar, ai deklaroi: “Kurrë nuk kam dëgjuar fjalë më të mençur se sa këto sa i përket përkorisë në ngrënie. Këto janë me të vërtetë fjalë të mençura!”[26] Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë) njëherë tha: “Ngopja është fillesa e sëmundjes, dhe ethet fillesa e ilaçit. Le të mësohet çdo trup me atë që ai është mësuar”. Në gjykimin tim, habia e mjekut të sipërpërmendur buronte nga kjo Traditë e dytë, dhe jo nga e para.

Ka thënë Ibën Salimi: “Cilido që ha bukë gruri dhe asgjë tjetër, dhe e bën këtë me etiketë, nuk ka për t’u kapluar kurrë nga sëmundja, përpos nga sëmundja që do t’i sjellë vdekjen.” Ai u pyet se cila mund të ishte etiketa e duhur, dhe ai u përgjigj: “Të hash mbas fillimit të urisë, dhe të ndalesh përpara fillimit të ngopjes”.

Një doktor me sjellje të nderuar e dënoi njëherë teprimin në ngrënie duke thënë: “Gjëja më e dobishme që një njeri mund t’ia lejoj barkut të tij është një shegë.[27] ndërkohë që gjëja më dëmprurëse për atë është kripa.[28] Unë parapëlqej më tepër që një njeri të pakësoj sasinë e kripës se sa të shtojë numrin e shegëve që ha.”

Në një Traditë thuhet: “Agjëroni, dhe ju keni për të qenë të shëndetshëm”[29]. Agjërimi, uria dhe ngrënia e pakët shpiejnë pra në shëndet të trupit, kështu që ai i bëhet i çliruar nga çrregullimet, si dhe në shëndet të zemrës, e cila bëhet e çlirët nga sëmundjet e rebelimit dhe ngazëllimit, si edhe nga një mori ankesash të tjera.

[9] Dobia e nëntë shtrihet në shpenzimet e pakësuara. Cilido që mësohet me ngrënien e pakët ka për të zbuluar se një e ardhur modeste është e mjaftueshme, kurse një njeri që e ka bërë zakon ta mbushë barkun plot ka për të zbuluar se stomaku i tij bëhet një borxhdhënës nga i cili është e pamundur të shpëtosh, i cili e kap atë për fyti çdo ditë, duke i thënë: “Çfarë ke sot për të ngrënë?” Për rrjedhojë, ai ka për të qenë i shtrënguar që të hyjë në gjithëfarë aktivitete, dhe ose të nxjerrë para nga veprimtari të paligjshme, kështu që ai bie në gjynah, ose nga ato të ligjshme, të cilat kanë për ta përfshirë atë në poshtërim dhe rraskapitje. Ai mund mund të ketë nevojë që ta drejtojë vështrimin e tij lakmitar drejt njerëzve të tjerë,[30] e cila është forma më e skajshme e uljes dhe degradimit. Nevojat e një besimtari janë të pakta: një urtar njëherë vërejti se “unë kënaq pjesën më të madhe të nevojave të mia duke hequr dorë prej tyre, gjë që, ndër të tjera, është më qetësuese për zemrën time”. Dikush tjetër ka thënë: “Sa herë që unë ndiej një dëshirë për të huazuar para nga dikush për hir të të kënaqurit të një

dëshire apo për të bërë një investim, unë huazoj nga vetja ime, në të cilën pikë heq dorë nga dëshira. Kësodore, unë jam huadhënësi më i mirë i vetes sime”.

Ibrahim ibn Ed'hemi (Zoti pastë rahmet për të), i pyeste bashkëshoqëruesit e tij në lidhje me çmimin e ushqimit. Kur i thuhej se ishte i lartë, ai thonte: “Uleni duke hequr dorë prej tij!”

Ka thënë Sehli (Zoti pastë rahmet për të): “Grykësia është e ulët në tri rrethana: nëse ai shpenzon kohën e tij në adhurim, ai ka për t’u bërë përherë e më dembel; nëse ai ka një zanaat, ai nuk ka për të qenë i pacënuar nga të këqijat e zanatit të tij; dhe nëse ai ka një të ardhur private, ai nuk ka për t’i dhënë Zotit atë që i takon Atij”.

Përmbledhtazi, pra, arsyeja përse njerëzit shkatërrohen shtrihet në lakminë e tyre për gjërat e dynjasë. Kjo lakmi, nga ana tjetër, prodhohet nga dëshira për ushqim, dhe nga dëshira seksuale, duke qenë se kjo e fundit është pasojë e të parës. Të gjitha këto porta mund të mbyllën në sajë të një diete të përkorë; ato porta cojnë në Ferr, të cilat, kur mbyllën, hapin porta për në Parajsë: siç ka thënë Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë): “Përdoreni urinë për të trokitur pareshtur në portat e Parajsës”. Rrjedhimisht, cilido që mbetet i kënaqur me një çyrek të vetëm buke çdo ditë, ka për të mbetur i kënaqur edhe sa i përket dëshirave të tjera të tij gjithashtu, dhe ka për t’u çliruar, meqenëse ai nuk ka për të patur nevojë për të tjerët, dhe ka për gjetur prehje nga veprimtaritë tokësore, kështu që ai mund t’i përkushtohet adhurimit të Zotit (i Madhëruar dhe i Lëvdur është Ai) dhe tregtisë për Jetën e Amshuar, duke iu bashkangjitur kësodore atyre që Zoti i përshkruan si *Njerëz të cilët as tregtia e as shitja nuk ua shpëtojnë mendjen nga përkujtimi i Zotit.*<sup>[31]</sup> Të tillë njerëz janë të çliruar nga kjo gënjeshtëri thjesht e vetëm për shkak se, falë të qenit të kënaqur me kësmetin e tyre, ata mund të bëjnë edhe pa atë. Mirëpo, ai i cili ka nevojë për më tepër, duhet detyrimisht të gënjejhet.

Dobia e dhjetë është se muridit [aspirantit] i jepet mundësia të vendosë të tjerët përpara vetes së tij, dhe t’ua japë në bamirësi jetimëve dhe skamnorëve atë që është tepriçë te nevojat e tij. Në Ditën e Ngritjes, apo Ditën e Kijametit, atij ka për t’i bërë hije bamirësia e tij, siç thuhet në hadith.<sup>[32]</sup> Ajo që ai ha magazinohet në nevojtoje, kurse ajo që ai e jep në bamirësi shkon në depon që është mëshira e Zotit: për rrjedhojë, njeriu përfiton nga pasuria e vet vetëm për aq sa ai e jep atë, kur ai ka për të bërë atë të përhershme, pikërisht siç kur e han, ai e shkatërron atë, dhe kur e vesh atë, ai e vjetëron atë.<sup>[33]</sup> Dhënia e atij ushqimi që nuk i nevojitet njeriut është shumë më e mirë, pra, se sa mostretja apo ngopja.

Hasani (Zoti pastë rahmet për të), sa herë që recitonte fjalët e Zotit (i Lartësuar është Ai), *Ne i dhamë Amanetin qiejve, tokës e maleve, por ato u mpakën nga peshë e tij, dhe u trembën nga ajo; dhe atë e mori njeriu. Pa dyshim, ai është treguar tiran dhe i marrë,*<sup>[34][35]</sup> thonte [duke komentuar]: “Ai ia dha shtatë qiejve palë-palë, të cilët janë *udhët*<sup>[36]</sup> të cilat ai i stolisi me yje, dhe bartësit e *Fronit Madhështor*, apo *‘Arshit*. Ai iu tha atyre (i Lëvdur dhe i Lartësuar është Ai): “A keni për ta mbajtur këtë amanet, dhe gjithçka që buron prej tij?” “Dhe çfarë buron prej tij?” e pyetën ato. Ai iu përgjigj: “Se nëse ju bëni mirë, ju keni për t’u shpërblyer, dhe nëse ju bëni keq, ju keni për t’u ndëshkuar.” “Jo!” u përgjigjën ato. Mandej Ai ia dha atë tokës në të njëjtën mënyrë, edhe ajo e refuzoi gjithashtu. Dhe Ai ia dha atë maleve të ngulitura, të dukshëm dhe të lartë: “A keni për ta mbajtur këtë amanet, dhe gjithçka që buron prej tij?” “Çfarë buron prej tij?” pyetën ata. Ai përmendi edhe njëherë shpërblimin dhe ndëshkimin, dhe ata e refuzuan. Mandej Ai ia dha atë njeriut, i cili e mori atë përsipër. *Pa dyshim, ai është treguar tiran ndaj vetes së tij, dhe i marrë* sa i përket urdhëresave të Zotit të tij. Pasha Zotin, unë kam parë njerëz që shesin Amanetin për hir të pasurisë së tyre, duke përfutur mijëra e mijëra në këtë mënyrë. E megjithatë, ç’dobi u bënë ato atyre? Zgjeruan shtëpitë e tyre, dhe ngushtuan varret e tyre.<sup>[37]</sup>



Ata dhjamosën kuajt e tyre, dhe lanë pa ngrënë fenë e tyre. Ata u vunë në ndjekje të [kapriçove të] veteve të tyre duke u shfaqur mëngjes e mbrëmje përpara portave të sundimtarit, duke iu ekspozuar kësodore ngasjeve të rënda, ndonëse Zoti u pat dhënë atyre një komoditet të mjaftueshëm. Njëri prej tyre thotë: “Vihuni në kërkim të aksh e aksh gjëje për mua, dhe sillmëni aksh e aksh gjë,” duke u mbështetur në anën e tij të majtë teksa konsumon paratë e njerëzve të tjerë. Në gojën e tij ka tallje e përqeshje, paratë e tij u fituan në mënyrë të paligjshme, derisa, kur barku i tij të fryhet, dhe mostretja ta pllakosë, ai thotë: “Djalosh! Më gjej diçka që do të më ndihmojë të tresë ushqimin!” Ti, or faqezi! Mos është vallë ushqimi yt që dëshiron ta tresësh? Ti, në të vërtetë, po tret fenë tënde! Ku është i vobekti? Ku e veja? Ku skamnori? Ku jetimi? Janë pikërisht ata që Zoti të ka urdhëruar t’iu ndihmoh!”

[10] Kjo përbën një referencë ndaj dobisë [së dhjetë], e cila nënkupton dhurimin e ushqimit të panevojshëm të varfërve, kështu që të vihet mënjanë diçka më me mirë se sa ç’do të fitohej nga ngrënia e saj, dhe kësodore të shmanget të qenit i ngarkuar me një tjetër gjynah.

I Dërguari i Zotit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pa njëherë një njeri barkaluc, dhe tregoi me gisht barkun e tij. “Në qoftë se kjo do të ishte gjetiu,” vërejti ai, “kjo do të ishte më e mirë për ty”, me anë të së cilës gjë ai donte të thonte: “në qoftë se do ta kishte shpenzuar më mirë për Jetën tënde të Amshuar, dhe ta përdorje atë për të vënë të tjerët përpara vetes tënde”.[\[38\]](#)

Rrëfëhet se njëherë Hasani ka thënë: “Pasha Zotin, kur kam qenë i ri kam njohur njerëz të cilët, në mbrëmje, do të merrnin ushqim të mjaftueshëm për veten e tyre, por të cilët, kur fillonin të hanin, do të thonin: “Pasha Zotin, nuk kam për t’ia dhënë gjithë këtë barkut tim, derisa t’i kem dhënë një pjesë prej tij Zotit””.

Këto, pra, janë dhjetë dobitë e urisë. Nën çdonjërin prej tyre janë përfshirë nënndarje të panumërta me një përfitim të pallogaritshëm. Sepse uria është një depo e madhe për dobitë që e ndihmojnë njeriun në Jetën e Amshuar: siç ka thënë njëri prej të Parëve [se/efëve]: “Uria është kyçi i Jetës së Amshuar, dhe porta drejt heqjes dorë, ndërkohë që ngopja është kyçi për në dynja dhe porta drejt lakmisë.” Kjo është mëse e qartë nga Traditat, apo hadithet, që ne kemi cituar, të cilat ju mund t’i kuptoni sa më gjerësisht duke studiuar imtësitë e secilës dobi, kështu që të ngriheni mbi nivelin e thjeshtë të të besuarit. Megjithatë, në qoftë se nuk i mësoni këto gjëra, por thjesht besoni në vlerën e urisë, keni për të qenë në nivelin e atyre që e marrin besimin e tyre nëpërmjet imitimit [*taklid*].

Dhe Zoti e di më së miri.

Përktheu: Arjol Guni

[\[1\]](#) Për pjesën tjetër të këtij *hadithi* shiko më sipër, fq. 108.

[2]Kuran 58:11

[3] Arabisht: *basire*, term ky i cili për Gazaliun tregon aspektin intuitive të intelektit. Krahaso me Jabre, *Lexique*, 32-6.

[4]Burim i pa identifikuar (Zabidi, 7, 394). Megjithatë ekziston një tjetër hadith i mirënohur në të cilin pohohet: “Duhet të qeshësh rrallë sepse e qeshura e shumtë të vdes zemrën”. Tirmidhi, *Zuhd*, 2; Ibn Maxheh, *Zuhd*, 19.

[5]Burim i paidentifikuar, Zabidi, 7, 395.

[6]Burim i pa identifikuar, Zabid, 7:395. Megjithëkëtë, ekziston një tjetër hadith me kuptim të ngjashëm: “Ka një zekat për çdo gjë dhe zekati i trupit është agjerimi”. Ibn Maxheh, *Sijam*, 44.

[7]Tabarsi, 171.

[8]Ibn Hanbel, *Musned*, 5, 254; Tirmidhi, *Zuhd*, 35.

[9]

[10] Krahaso me Traditën në të cilën profeti thotë: “Ne, Profetët, jemi nga të gjithë njerëzit ata që sprovohen me më tepër hidhërim, më të mirët nga ne më rëndë”. (Tirmidhiu, *Zuhd*, 57; Ibn Maxhe, *Fitan*, 23; el-Hakim el-Tirmidhiu, *Bejan el-ferk*, 90.)

[11]Kut al-Kulub, 1, 96.

[12]Hadith Profetik, Tirmidhi, *Iman*, 8; Ibn Maxheh, *Fiten*, 12.

[13] Krahaso me hadithin, “imoraliteti syve është vështrimi ngultaz” (Buhariu, *Isti’dhan*, 12; Muslimi, *Kader*, 21). Shiko më poshtë, fq. 172-5.

[14] Syri, veshi, gjuha, gjenitalet, këmbët, duart dhe stomaku. (Gazaliu, *Bidaje*, 74 [përktheu Abul Quasem, 73].)

[15] Kut al-Kulub, 1, 96.

[16] Një namaz vullnetar, ndonëse me mjaft vlera, që duhet të kryhet në fillim të një të tretës së fundit të natës. Krahaso me *Ihja'*, I. 176 (*K. Esrar el-salat*, bab 7, kism 1); gjithashtu *Ihja'*, I. 321-4 (*K. tertib el-evrad*, bab 2).

[17] Krahaso me hadithin “Gjumi është vëllai i vdekjes” (*Ihja'*, IV. 431 [*K. Dhikr el-meut*, bab 7, kism I]); gjithashtu *Ihja'*, I. 321-4 (*K. Tertib el-evrad*, bab 2).

[18] Një namaz që ose mund të falet përpara rënies në gjumë natën, ose të shtyhet deri në fund të *tehexhshut*-it. (*Ihja'*, I. 175 [*K. Esrar el-salat*, bab 7, kism 1].)

[19] *Ihja'*, I. 123-5 (*K. Esrar el-tahare*, kism 3, nev' 1). Rreziqe të tjera përfshijnë humbjen e sensit të modestisë, duke qenë se vështrohesh nga të tjerët, çuarjen dëm të ujit, e kështu me radhë. Siç thuhet, Ibn Omeri e kishte zakon të lidhte sytë në brendësi të hamamit. Islami këtu vijon një debat të moçëm.

Tmerri i Shën Agustinit nga banjat publike të kohës së tij është i mirënjohur, ndërkohë që Politini e shmangte banjën publike për arsye morale (krahaso me VVallis, *Neoplatonism*, 9). S'është nevoja që të vrojtohet se gjinitë ishin të ndara në hamamet e Lindjes së Afërme, sipas rregullit islam.

[20] Gjendja rezultuese e ndotjes (*xhenabe*) e bën të paligjshme për një mysliman apo myslimane që të kryejë namazin e detyrueshëm, të prekë ose të këndojë Kuran, ose të shkelë në një xhami, derisa ai apo ajo të ketë marrë *gusul*: një larje kjo e të gjithë trupit. (*Ihja'*, I. 121 [K. *el-Tahare*, kism 2].)

[21]Kuran 10:7

[22]Kuran 30:7

[23] Arabisht *el-helilexh el-esued*. Njëbar mjekësor indian i përdorur për të kuruar ligështi të ndryshme, përfshirë leprozën (*xhudham*). Shiko Ibn Sina, *Kanun*, 65-7; Ibn el-Hashsha', *Mufid*, 129-30; Levey, *Medical Formulary of Al-Samarqandi*, 26.

[24] Arabisht *habb el-reshad el-ebjad*. E përdorur për lebrozën, sëmundjet e shpretkës, dhe sëmundjet e grave. Shiko Graziani, "Ibn Jazlah's Eleventh Century Tabulated Medical Compendium", 307; Levey, 239.

[25] Një i krishterë apo çifut. Jo-myslmanët dominonin profesionin mjekësor gjatë periudhës abasite. (Dols, *Medieval Islamic Medicine*, 41, dhe referencat e cituara aty.)

[26] Ose, "këto janë fjalët e një filozofi/urtari/mjeku" [*kelam hakim*].

[27] Komentuesi këtu vëren: "Për shkak se [...] ajo nuk të shëndoshë." (Zabidiu, VII. 400), i cili është gjithashtu edhe gjykimi i Ibën Sinait. (*Kanun*, 278).

[28] Zabidiu na tregon se kripa "ndeç gjakun, dobëson shikimin dhe dëmton trurin dhe mushkëritë" (Zabidiu, në pasazhin e cituar tashmë). Shiko më tutje Ibën Sinain, *Kanun*, 195-7.

[29]Taberani, El-Mu'xhem el-Eusat (Sakhaui, 381); Al-Kudai, 1, 108.

[30] Domethënë, ai mund të katandiset në lypje.

[31]Kuran, 24:37

[32]Hakimi, 1:416. "Çdo njeri është do të jetë nën hijen e bamirësisë së tij"

[33] Një jehonë e një hadithi: "Njeriu pyet, "Ku është pasuria ime?" Por, o njeri, a ka pasuri që e ke tënden, përpos asaj që ti e ha dhe e shkatëron, apo që e vesh dhe e vjetëron, apo që e jep dhe e bën atë kësisoj të përhershme?" (Muslimi, Zuhd, 3.)

[34]Kuran, 33:72.

[35] Për Amanetin [*emane*] shiko Schimmel (*Mystical Dimensions*, 188), e cila vëzhgon se "është interpretuar në mënyra të ndryshme: si përgjegjësi, vullnet i lirë, dashuri, ose fuqia e individualizimit". Sipas Kushejriut, opinionet e të cilit rregullisht adoptohen nga Gazaliu, ai duhet të identifikohet me njohjen e Unitetit Hyjnor, dhe binjen ndaj Ligjit të shpallur. (*Lata'if*, III. 173.) Më tutje shiko Taberiu, *Tefsir*

, XXII. 38-41; Massignon, *Passion*, III. 13.

[36] Dhe Ne kemi krijuar mbi ju shtatë udhë [*tara'ik*] (K. XXIII:17). Krahaso me Asad, 520: 'shtatë orbitat [qiellore]'.

[37] Një aluzion për 'ngushtimin e varrit', ndëshkim ndaj të cilit disa gjynahqarë do t'u nënshtrohen ndërmjet kohës së varrosjes së tyre dhe Ringjalljes. Shiko *Ihja'*, IV. 429-30 (K. *Dhikr el-Meut*, bab 7, bejan su'al...; përktheu VVinter, *Remembrance of death*, 144-8.

[38]Tajalisi, 171, Abu Ja'la, El-Musned (Hejthemi, Mexhmu', v.31).

**Date Created**

20/04/2021

**Author**

erasmusi